

Znj. Ardiana Hala, prej Janarit 2019 mban postin e Drejtorit të Drejtorisë Juridike.

Znj. Hala ka kryer studimet e Larta në:

Master Shkencor “E drejtë kushtetuese dhe administrative” Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Drejtësisë, 2017; Studimet e Larta Universitare /Jurist Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Drejtësisë, 2015; Master i Shkencave në “Përkatësia Gjinore dhe Zhvillimi” Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, 2012; Studimet e Larta Universitare/Punonjës i filozofisë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Filozofi-Sociologjisë, 1992.

Znj. Hala ka eksperiencë të gjatë në administratën publike, fillimisht si Këshilltare e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 2010 – 2015; më pas Drejtore e Drejtorisë Procedurale, Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, 2015 – 2018, periudhë me një përvojë shumë të mirë në konceptimin e iniciativave në shërbim të funksioneve për të cilat është ngarkuar KMD, në cilësinë e drejtueses së grupeve të punës (hartimin e strategjive dhe planeve të veprimit, PBA, realizimin e studimeve dhe hartimin e raporteve), në realizimin e bashkëpunimit me OJF-të, organizmat ndërkombëtare dhe institucionet qëndrore dhe vendore, pjesëmarrje në seminare, konferenca, etj.

Znj. Hala ka një eksperiencë të gjatë edhe në sektorin privat, ku është angazhuar si Drejtore Ekzekutive në disa Shoqeri Tregëtare, 1999 – 2010, me përvojë në drejtimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore dhe financiare.

Gjithashtu, ka eksperiencë edhe në fushën e Arsimit, 1992 – 1993.

Znj. Hala ka ndjekur me sukses shumë trajnime me synim rritjen e profesionalizmit në trajtimin e çështjeve të diskriminimit, sidomos të grupeve vulnerabël; në kuadër të vizitave studimore pranë institucioneve homologe me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi në vendet europiane dhe ballkanike.

Znj. Hala është trajnuar dhe certifikuar edhe nga Këshilli Europës, si:

HELP Training of Trainers(ToT)

Trajnim i zhvilluar në kuadër të Programit European për Edukimin mbi të Drejtat e Njeriut për Profesionistët e Ligjit(HELP);

Kurset On-line HELP

Trajnim i zhvilluar në kuadër të Programit European për “Edukimin mbi të Drejtat e Njeriut për Profesionistët e ligjit(HELP) për çështjet e diskriminimit”; si dhe “*Business and Human Rights*”.